



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 150/2019

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Vlerona Maliqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të përfshirjes në fushatë zgjedhore të pjesëtareve të uniformuar të Policisë së Kosovës dhe përdorimit të gjuhës së urrejtjes për subjektet politike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur më datë 04.10.2019, mori këtë:

## V E N D I M

**I. PRANOHET PJESËRISHT** e bazuar ankesa Anr.150/2019 e datës 01.10.2019, e paraqitur nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dhe subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, i SHQIPOHET gjobë në lartësi prej 4,200.00 (katërmijë e dyqind) euro, për shkak të përdorimit të pjesëtarëve të uniformuar të Policisë së Kosovës në fushatën e zgjedhjeve, të cilën shumë detyrohet ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga plotfuqishmëria e këtij vendimi, nën kërcënim të përbarimit.

**II. REFUZOHET PJESËRISHT** e pabazuar ankesa Anr.150/2019 e datës 01.10.2019, e paraqitur nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, sa i përket pretendimit për përdorim të gjuhës së urrejtjes për subjektet politike, në fushatë zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 06.10.2019.

## A r s y e t i m

PZAP-i, më datë 01.10.2019, ka pranuar ankesën Anr.150/2019, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, me të cilën pretendohet se kandidati për deputet nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Faton Bislimi, më datë 01.10.2019, rreth orës 09:43 minuta, përmes llogarisë së tij në facebook, ka bërë fushatë me Policinë e Kosovës, ashtu që ka publikuar një foto me Gardën e Policisë së Kosovës, dhe një shkrim mbi fotografi, i cili shpreh gjuhë të urrejtjes, duke vënë theksin se: “Lëvizja Vetëvendosje e cila pretendon drejtimin e shtetit nuk i njeh simbolet e shtetit dhe as nuk respekton ato”, duke vazhduar se kjo është hipokrizi. Po ashtu, sipas paraqitësit të ankesës, në pjesën e dytë të tekstit në fjalë, akuzohet subjekti politik LVV edhe për mosrespektim të minoritetit serb, veprime këto të cilat sipas paraqitësit të ankesës bien në kundërshtim me dispozitat ligjore të LZP-së, përkatësisht nenin 33, pika 1) të këtij ligji dhe

Rregullën Zgjedhore Nr.13/2013 për “Fushatën e Zgjedhjeve dhe Njoftimin për Ngjarjet Politike”, të ndryshuar dhe plotësuar me Rregullën Zgjedhore Nr.20/2019, neni 5 par.2, pika c) e rregullës në fjalë. Në fund ka kërkuar nga PZAP-i, që subjekti i cili ka bërë shkeljet e lartëcekura të sanksionohet sipas legjislacionit në fuqi.

Paraqitësi i ankesës, si dëshmi për pretendimet e tij, ankesës ka bashkangjitur shkrimin e kandidatit për deputet nga radhët e subjektit politik LDK, Faton Bislimi, të postuar në llogarinë e tij në facebook.

PZAP-i, në kuptim të nenit 7 paragrafi 1, të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e ka njoftuar subjektin politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për ankesën që është bërë ndaj tij dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj saj deri më datë 02.10.2019, në ora 09:00. Në përgjigje në ankesë të datës 01.10.2019, subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), konsideron se pretendimet e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje janë jo të drejta, për faktin se postimi i kandidatit për deputet nga radhët e tyre, Faton Bislimi, i postuar në llogarinë e tij në facebook, shpreh mendime dhe opinione të tija personale, dhe nuk mundet asnjë subjekt politik t’ia kufizojë lirinë e shprehjes askujt, duke theksuar se shkrimi nuk përmban elemente të provokimit, por është në përputhje me konditat ligjore dhe parimet kushtetuese të lirisë së shprehjes. Sa i përket fotos së bashkangjitur në shkrim-status, paraqitësi i përgjigjes në ankesë ka konsideruar se postimi i kësaj fotografie, nuk bie në kundërshtim me dispozitën e rregullës zgjedhore në të cilën pretendon paraqitësi i ankesës, për faktin se pjesëtarët në rastin konkret të Gardës së Nderit, nuk janë të angazhuar sipas detyrës zyrtare, por ajo është një foto e mëhershme e cila nuk përkon fare me pretendimin ankimor. Në fund ka shtuar se, pavarësisht kësaj, nga ana e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), janë ndërmarrë masa përmirësuese për evitimin e shkeljes së pretenduar, ashtu që kandidati për deputet ka fshirë postimin në fjalë nga llogaria e tij në facebook, me ç’rast ka bashkangjitur foton në përgjigje në ankesë, megjithëse nga ana e tyre nuk konsiderohet se në rastin konkret ka elemente për sanksionim.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 paragraf 2, të LZP-së, gjeti se: **Ankesa është pjesërisht bazuar**, për këto arsye:

Paneli, nga postimi i fotografisë dhe tekstit mbi të, të postuara në llogarinë e facebook-ut të kandidatit për deputet nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Faton Bislimi, të ofruara si provë materiale, përgjigjes në ankesë të subjektit politik LDK, dhe shkresave tjera të lëndës, ka vlerësuar se nga ana e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), është shkelur Rregulla Zgjedhore Nr.13/2013, për “Fushatën e Zgjedhjeve dhe Njoftimin për Ngjarjet Politike”, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregullën Zgjedhore Nr.20/2019 të datës 26.09.2019, pasi që koalicioni në fjalë, me qëllim të promovimit të programit të subjektit të tyre politik, gjatë fushatës zgjedhore, në aktivitetin e tij promovues zgjedhor, ka përfshirë pjesëtarë të uniformuar të Policisë së Kosovës, veprim ky i cili bie në kundërshtim me dispozitën e nenit 5 par. 2, pika c), të rregullës zgjedhore të lartpërmendur, ku ndër të tjera parashihet se: “Në fushatën e zgjedhjeve të asnjë subjekti politik të certifikuar nuk mund të përfshihen kategoritë: ...; c) pjesëtarët e uniformuar të Policisë së Kosovës dhe personeli i tyre, përveç kur janë të angazhuar sipas detyrës zyrtare”.

Paneli me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë; si dhe

- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret, se subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se është njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe përkundër këtij fakti gjatë fushatës zgjedhore, në aktivitetin e tyre zgjedhor kanë përfshirë pjesëtarë të uniformuar të Policisë së Kosovës, veprim ky i sanksionuar me dispozitën e lartëcekur të rregullës zgjedhore.

Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që subjekti politik LDK, në përgjigje në ankesë, ka deklaruar se nga ana e tyre janë marrë masa përmirësuese, ku është evituar shkelja. Ndërmarrja e masave përmirësuese nga ana e subjektit politik në fjalë ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi, sepse sipas nenit 3 paragrafi 2 i Rregullores së PZAP-it, Nr. 01/2012, për shkeljet e kësaj natyre të Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, mund të shqiptohet gjobë nga 5,100.00 euro deri në 20,000.00 euro, për subjektet politike që kanë qenë të përfaqësuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës, mirëpo siç u konstatua me lart, veprimet e subjektit politik LDK, për ta përmirësuar shkeljen, kanë ndikuar në uljen e lartësisë e gjobës, andaj duke u bazuar në këto fakte, paneli vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij vendimi.

Në raport me refuzimin e pjesërishëm të ankesës sa i përket pretendimit të paraqitësit të ankesës, se nga ana e kandidatit për deputet nga radhët e subjektit politik LDK, është përdorë gjuhë e urrejtjes ndaj subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, Paneli vlerësoi se i njëjti është i pabazuar për faktin se paraqitësi i ankesës nuk ka arritur të argumentojë këtë pretendim të tij. Nga shikimi i postimit të bërë nga kandidati për deputet nga radhët e subjektit politik LDK, Faton Bislimi, nuk shihet se nga ana e këtij kandidati është përdorë gjuhë e urrejtjes ndaj ndonjë subjekti politik për faktin se ky shkrim përmban një gjuhë normale ku shprehen opinionet personale të një kandidati për deputet, si dhe nuk bërë specifikim i ndonjë subjekti politik, koalicioni, kandidati apo ndonjë personi tjetër të cilit i drejtohet ky shkrim, andaj Paneli vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi.

Nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 118 par.1 dhe nenit 120 par.1 pika c) të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
Anr.150/2019 më datë 04.10.2019

**Kryesuesi i Panelit**  
Faton Ademi



**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së,